



Mali i zi
Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të
pakicave
Nr: 242 /23
Podgoricë, 27.03.2023

Në bazë të nenit 36h Ligjit mbi të Drejtat dhe Liritë e Pakicave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 31/06, 51/06 dhe 38/07 dhe "Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/11 dhe 31/17), lidhur me Vendimin mbi themelimin e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave („Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr.13/08, 64/11,068/17), sipas dispozitave të Rregullores për metodën e vlerësimit të projekteve të cilat financohen nga Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave („Gazeta Zyrtare e Mali të Zi“, nr.64/18), Komiteti drejtues, në pajtim me Vendimin për thirrjen publike për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetje të aktiviteteve nga neni 36 paragrafi 1 i Ligjit për të drejtat dhe liritë e pakicave për vitin 2023, të miratuar në seancë mbajtur më 27 mars 2023. shpallë

Thirrje publike
për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për përkrahje të aktiviteteve nga neni 36
paragrafi 1 i Ligjit mbi të Drejtat dhe Liritë e Pakicave, për vitin 2023

Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave të Malit të Zi (në tekstin e mëtejshëm: Fondi) do të financoj dhe bashkëfinancoj, në vitin 2023, projektet e rëndësishme për mbrojtjen dhe zhvillimin e veçorive nacionale, gjegjësisht veçorive etnike të pjesëtarëve të popujve pakicë si dhe komuniteteve tjera kombëtare minoritare, që realizohen në Mal të Zi.

Shpërndarja e mjeteve nga Thirrja publike zhvillohet në bazë të kritereve:

1. ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar, fetar, gjuhësor dhe etnik të popullit minoritar ose të komunitetit kombëtar minoritar;
2. pajtueshmëria e projektit me dokumentet strategjike të Qeverisë së Malit të Zi;
3. kontributi në bashkëpunim ndërkulturor dhe në zvogëlim të distancës etnike;
4. promovimi i frymës së tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe respektit e mirëkuptimit të ndërsjellë;
5. transparenca dhe mundësia e kontrollimit të realizimit të projektit; dhe
6. kapacitetet profesionale dhe teknike të aplikuesit.

Të drejtë të marrin pjesë kanë organizatat joqeveritare, subjektet juridike dhe personat fizik, aktivitetet e të cilëve janë të drejtuara drejtë mbrojtjes dhe zhvillimit të veçorive nacionale, gjegjësisht veçorive etnike të popujve pakicë si dhe komuniteteve tjera kombëtare minoritare si dhe pjesëtarëve të tyre, në fushën e identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Të drejtë të marrin pjesë në thirrje publike nuk kanë këshillet e popujve pakicë dhe komuniteteve tjera kombëtare minoritare.

Në thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve, nuk mund të marrin pjesë organizatat joqeveritare, subjektet juridike dhe personat fizik të cilëve, gjatë vitit kalendarik, me vendim të Fondit, u janë financuar dy projekte, ose një projekt me shumën e 5% të fondit total të mjeteve të përcaktuara për financimin e projekteve për përkrahjen e aktiviteteve nga neni 36 paragrafi 1 i Ligjit mbi të Drejtat dhe Liritë e pakicave.

Projekti dorëzohet në formularin e duhur, të përcaktuar sipas Rregullores për metodin e vlerësimit të projekteve të cilat financohen nga Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave („Gazeta Zyrtare e Mali të Zi“, nr.64/18) që përmban: - emërtimin " FONDI PËR MBROJTJEN DHE REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE" dhe "Formularin e projektit që dorëzohet në thirrjen publike për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të përmendura në nenin 36j të Ligjit mbi të Drejtat dhe Liritë e pakicave," të dhënat mbi aplikuesin e projektit, të dhënat mbi fushat e veprimtarisë së aplikuesit të projektit, të dhënat mbi projektin, të dhënat mbi partnerin nëse aplikohet në partneritet, vendin dhe datën e plotësimit të të dhënave mbi partnerin, vendin për vulë, emrin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për ta përfaqësuar partnerin, gjegjësisht, emrin dhe nënshkrimin e personit fizik që është partner në projekt, të dhënat mbi mjetet financiare të nevojshme për realizimin e projektit, vendin dhe datën e dorëzimit të projektit, vendin për vulë, emrin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për ta përfaqësuar aplikuesin e projektit dhe një listë dokumentash që i bashkëngjitet këtij projekti, si edhe një shënim se projektet të cilat nuk janë dorëzuar në formën e përshkruar, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe të cilat nuk janë dorëzuar brenda afatit të caktuar, që nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga kjo thirrje, nuk do të konsiderohen.

Formulari është i disponueshem në web faqen e Fondit www.fzm.me

Dokumentacioni i kërkuar:

Formulari i lartpërmëndur duhet të shoqërohet me dokumentacion, si më poshtë vijon:

- një raport i hollësishëm për mjetet e shpenzuara në vitin e kaluar, bashkë me një kopje të faturave, kontratave dhe deklaratave nga bankat ku janë paguar, me pasqyrim tabelor të mjeteve të shpenzuara për vitin e kaluar dhe me sqarime, me planin e mediave, me materiale promovuese dhe botime të tjera, gjegjësisht, një deklaratë të verifikuar se aplikanti nuk ka përdorur mjetet nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave (në tekstin e mëtejshëm: Fondi), në vitin e kaluar;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, që mjetet për shumën e kërkuar nuk i ka marrë nga donatorët tjerë;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, që informacionet e dhëna në propozimin e projektit janë të sakta;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, që mjetet e marra në bazë të thirrjes publike nuk do të përdoren për të mbuluar humbjet e detyrimeve të tjera;
- deklarata e verifikuar e partnerit, për pranimin e pjesëmarrjes në projekt në shumën e mjeteve të treguara në projekt, nëse projekti dorëzohet në partneritet;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, se projekti që ai dorëzon nuk do të ketë përdorim komercial ose fitimprurës;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, me të cilën konfirmohet se qëllimi i projektit nuk do të jetë krijimi i një organizatë apo shoqate;
- deklarata e verifikuar e aplikuesit, si vërtetim që mjetet e kërkuara nuk kanë për qëllim financimin e aktiviteteve zgjedhore, domethënë financimin e partisë politike;
- CD me propozimin e projektit dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e projektit në formën e përshkruar në format dokumenti Word.

Përveç dokumentacionit të referuar, aplikuesi i projektit i cili është:

1) subjekt juridik ose organizatë joqeveritare duhet të dorëzojë edhe:

- një kopje të regjistrimit pranë autoritetit kompetent;
- një kopje të aktit themelues;

- një kopje të Statutit;
- deklaratën e aplikuesit të vërtetuar se personi i autorizuar ose anëtarët e autoritetit drejtues të aplikuesit nuk janë në të njëjtën kohë anëtarët e komisionit të Fondit, të komitetit drejtues të Fondit, drejtori, të punësuarit apo vullnetarët e Fondit;
- vërtetimin e dorëzimit të raportit financiar për vitin e kaluar (dëshmi e paraqitjes së pasqyrave financiare, formulari IOPPD të nënshkruar nga Administrata Tatimore dhe një llogaritje nga banka ku pagesat e taksave dhe kontributeve janë të regjistruara);

2) personi fizik gjithashtu dorëzon:

- një kopje të biografisë - (CV-së), me theks të veçantë mbi përvojën e mëparshme në realizimin e projekteve në fushat e ruajtjes dhe zhvillimit të veçorive kombëtare dhe etnike të popujve pakicë dhe komuniteteve të pakicave të tjera kombëtare dhe pjesëtarëve të tyre në fushën e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor dhe fetar;
- të paktën dy rekomandime ose garanci nga organizata ose institucione, fusha e veprimtarisë së të cilave është objekti i thirrjes publike, duke konfirmuar që aplikuesi i projektit e ka kapacitetin për të realizuar projekt;
- një kopje të biografisë - (CV-së) e personit përgjegjës për zbatimin e projektit.

Vërejtje: Dokumentacioni që nënkupton vërtetim duhet të vërtetohet tek organet kompetente (Gjykata themelore, organi i qeverisjes lokale me juridiksion mbi punët e vërtetimit apo notari).

Projektet që janë lajmëruar në thirrje publike do të vlerësoj Komisioni për vlerësimin e projekteve sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 4 dhe 9 të Rregullores për metodën e vlerësimit të projekteve që financohen nga mjetet e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr.64/18), në formularin që është pjesë përbërës i Rregullores, që përmban: emërtimin "FORMULARI PËR VLERËSIMIN E PROJEKTEVE" dhe "Komisioni për vlerësimin e projekteve", emërtimin dhe vitin e publikimit të thirrjes publike, emrin e projektit, emrin dhe mbiemrin e aplikuesit, vendin për futjen e pikëve në bazë të çdo kriterit individual, gjegjësisht kriteret dhe shpjegimet për pikët e fituara, numrin e përgjithshëm të pikëve sipas të gjitha kriterëve, vendin për futjen e komenteve të pikëve të dhëna, vendin dhe datën e plotësimit të formularit dhe nënshkrimin e anëtarit të Komisionit, dhe që është i publikuar në web faqen e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut www.fzm.me.

Afati i aplikimit në Thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve fillon me **28.03.2023**, përmbyllur me **10.05.2023**.

Vendimi për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për përkrahjen e aktiviteteve nga neni 36 paragrafi 1 i Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e pakicave për 2023. do të publikohet në web faqen e Fondit www.fzm.me, dhe së paku në një media, me seli në Mal të Zi.

Formulari i projektit që paraqitet në konkursin publik për ndarjen e mjeteve për mbështetje të aktiviteteve nga neni 36j i Ligjit për të drejtat dhe liritë e pakicave duhet të jetë i plotësuar, nënshkruar dhe vulosur me vulë zyrtare për personat juridikë, për personat fizik duhet të jetë i plotësuar dhe i nënshkruar, i dorëzuar në tre kopje në formë të shtypur, një kopje në versionin elektronik - një CD me projekt propozimin dhe fondet e nevojshme për realizimin e projektit në formularin e përcaktuar në formatin Word. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur direkt ose në adresë:

Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave, Rr. Slobode, nr.85, Podgorica, me shkrim: Mos të hapet – për Thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për përkrahjen e aktiviteteve nga neni 36 paragrafi 1 i Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e pakicave, për vitin 2023.

Vërejtje: Projektet të cilat nuk janë dorëzuar në formën e përshkruar, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të cilat nuk janë dorëzuar brenda afatit të caktuar, gjegjësisht, që nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga ky konkurs, nuk do të konsiderohen.

Kontakt tel.+382 20 664 362

**Kryetari i këshillit drejtues
Marko Ugrin**